



Dhoma e Biznesit të Diasporës nis bashkëpunimin me AIDA dhe ADISA

Dhoma e Biznesit të Diasporës shqiptare nis bashkëpunimin me Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) dhe Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA). Sipas marrëveshjes së nënshkruar ditën e sotme dy agjencitë do të ofrojnë mbështetjen dhe konsulencë për shërbimet e reja që do të ofrohen pranë Dhomës së Biznesit të Diasporës shqiptare.

Interes i përbashkët i tre institucioneve është përmirësimi i klimës së biznesit në Shqipëri, përmirësimin i shërbimeve ndaj sipërmarrësve të Diasporës shqiptare si dhe nxitja e kapitalit investues të Diasporës në vendin e origjinës.

Ky bashkëpunim synon të jetë një mekanizëm i rëndësishëm në lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve në Shqipëri duke ndihmuar investitorët në hapat e para të sipërmarrjes së tyre në Shqipëri, me informacione mbi mundësitë e investimit dhe arsyet kryesore përse vendi ynë është potencial tërheqës për investimet e huaja, këshilla për mjedisin e përshtatshëm për suksesin e projekteve, rajoneve të funksionimit, planeve të investimeve, etj.

Përmirësimi i klimës së biznesit në vendin tonë, vendndodhja shumë e mirë gjeografike e kanë kthyer Shqipërinë në një destinacion me potencial të lartë të investuar me kosto të ulët biznesi.

Për të mësuar më shumë mund të lexoni materialin e plotë këtu:

<http://aida.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Albania-Calls.pdf>

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



Diaspora nga "eksodi i trurit" në "rrjetin e ekspertizës globale" në funksion të zhvillimit ekonomik dhe inovacioni

Nga Anila Hyka Smorgrav

Megjithëse vendi ka përjetuar gjatë 30 viteve të fundit një humbje të konsiderueshme të ekspertëve dhe intelektualëve, ana tjetër e medaljes është që Diaspora shqiptare sot numëron në gjirin e saj një gjeneratë me kapacitete të forta ekonomike, intelektuale dhe sociale. Pa u futur në shifra dhe statistika të ndryshme, të gjithë jemi koshtente se një përqindje mirë e popullsisë së Shqipërisë jetojnë jashtë vendit, ku në dy dekadat e fundit dominojnë të rinj në moshë shkollimi e pune.


Nga këto, sot një numër i konsiderueshëm janë të diplomuar të nivelit të lartë me një diplomë bachelor ose një diplomë pasuniversitare, po aq mund të konsiderohen në numër ajo pjesë që janë drejtues ose profesionistë në sektor privat, apo mbajtja e pozicioneve të rëndësishme akademike ose kërkimore shkencore.

Ndërkohë në Shqipëri kemi një ekonomi me indikatorë zhvillimi më të ulët në rajon dhe numër më të lartë papunësie. Ka iniciativa Inovacioni të fragmentuara të orientuara kryesisht në "start-up" sipërmarrje që kanë si objektiv kryesor gjetjen e mundësive financiare për të transferuar biznesin në tregun e huaj. Por sa përqind e kësaj kategorie merr pjesë në programet për zhvillimin ekonomik dhe teknologjik është pak e njohur. Pse i duhet vendit një zhvillim i inovacionit në një ekonomi që vazhdon të notojë për tre dekada në valët e tranzicionit post-komunist?

Vendet e Europës dhe vendet fqinjë kanë inovacionin si një nga indikatorët kryesor të zhvillimit ekonomik. Hapja e negociatave për në BE bën të domosdoshëm Inovacionin si një nga akset kryesore për reduktimin e hendekut me vendet e tjera, përfshirë dhe fqinjët tanë. Shqipëria ka akoma një nivel të ulët produktesh konkurrence në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar. Inovacioni është një faktor kyç për të rritur mundësitë e konkurrimit të produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregun ndërkombëtar. Inovacioni shërben për përmirësimin e produktivitetit, procedurave, thjeshtëzimit të sistemeve dhe kushteve të jetesës. Falë teknologjisë së avancuar dhe inovacionit shoqëria do të përfitojë transferim njohurish, rritje të aftësive profesionale, krijim ekspertizash të reja dhe tek e fundit një treg pune të qëndrueshme. Hendeku teknologjik në sistemin e edukimit publik në të gjitha nivelet, ka krijuar disnivele në shtresa të ndryshme të shoqërisë. [...]

Intervista e plotë: <https://www.adbc.al/diaspora-nga-eksodi-trurit-ne-rrjetin-e-ekspertizes-globale-ne-funksion-te-zhvillimit-ekonomik-dhe-inovacioni/>

*Autorja është drejtuese projektesh në Orange Telekom France



Industria e automotivës, Civici: Shans i mirë për thithjen e investimeve të huaja

[> Link <](#)



Përmasa e vërtetë e remitancave në Shqipëri – SCAN MAGAZINE

[> Link <](#)

Java në lajme



BSH paralajmëron uljen e normës bazë të interesit, 3 kanalet si tërmeti i 26 nëntorit do ndikojë ekonominë shqiptare

[>Link <](#)



FMN këshilla qeverisë për rindërtimin: Përgjegjshmëri e transparencë me fondet, jo përjashtime të reja nga taksat

[> Link <](#)

Dy vendime qeverie



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE


Këshilli i Ministrave ka miratuar në mbledhjen e radhës Vendimin për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, në lidhje me shërbimet ajrore.

Gjithashtu në këtë mbledhje është miratuar edhe Vendimi për përcaktimin e procedurës së vlerësimit të kontributit të donacioneve në formën e pasurive të paluajtshme në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "p", të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave.

Për të mësuar më shumë klikoni në linkun:

<https://kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-13-shkurt-2020>

Kursi zyrtar i këmbimit



Dollar Amerikan	USD	112.54	+0.48
Euro	EUR	122.05	+0.09
Poundi Britanik	GBP	146.54	+1.04
Franga Zvicerane	CHF	114.71	+0.05
Jeni Japonez (100)	JPY	102.50	+0.35
Dollari Australian	AUD	75.58	+0.20
Dollari Kanadez	CAD	85.01	+0.46

Rreth Dhomës së Biznesit për Diasporën Shqiptare

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është organizata e parë në shërbim të bizneseve të Diasporës. Si një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse, ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë dhe të nxisim bizneset e të gjitha madhësive për të maksimizuar potencialin e tyre në Shqipëri. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitorëve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese te tyre në atdhe.



Numrin e radhës të revistës Monitor mund ta lexoni këtu : www.monitor.al



Gazetën Çelësi mund ta lexoni këtu: <http://www.yellowpagesalbania.com>

